



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



PROGRAM

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: GJEOGRAFI E APLIKUAR

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Dhimitër DOKA
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (1.2 leksione dhe 1.2 seminare në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Programi i studimit:</i>	Master Shkencor, gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	II/II

Shkurtesë:

Lënda zhvillohet semstrin e parë në vitin e II-të të drejtimit Master Shkencor të degës gjeografi, lëndë me zgjedhje. Ajo ka për qëllim formimin e studentëve me njohuritë mbi kuptimin dhe nevojën e aplikimit në fushën e gjeografisë. Objekt i lëndës do të jentë analiza e mendimeve dhe kontributeve të ndryshme gjatë evoluimit të aplikimit gjeografik. Rëndësi e vecantë do ti kushtohet problematikave dhe metodikave të realizimit të aplikimit në kuadër të studimeve në fushën e gjeografisë. Gjithashtu vend të rëndësishëm do të zënë shembujt e shumtë që do të jepen në kuadër të aplikimit gjeografik në drejtime të ndryshme të studimeve gjeografike. Vend të vecantë do të zërë puna e pavarur e studentëve në përgatitjen dhe prezantimin e projekteve studimore mbi bazën e aplikimit gjeografik.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje në Gjeografinë Aplikuar. Çfarë përfaqëson Gjeografia e Aplikuar? A duhet të ketë një Gjeografi të Aplikuar? Në se po, pse duhet bërë ky aplikim, ku duhet bërë dhe kush duhet ta bëjë?

2. Ecuria e zhvillimit të Gjeografisë së Aplikuar. Fillimet e aplikimit gjeografik që nga lashtësia e deri në vitet pesëdhjetë të shek. XX. Hapat e rëndësishme të hedhura në evoluimin e Gjeografisë së Aplikuar gjatë viteve gjashtëdhjetë të shek. XX. Rëndësia e kontributit të viteve shtatëdhjetë të shek. të XX në zhvillimin e Gjeografisë së Aplikuar. Metodatat moderne të aplikimit gjeografik duke filluar nga vitet tetëdhjetë të shek. XX. Gjeografia e zbatuar si prodhim i kohës së vet.

3. Planifikimi dhe rregullimi i hapësirës – fusha kryesore e zbatimit të gjeografisë. Kuptimi mbi

planifikimin e hapësirës dhe rëndësia e aplikimit gjeografik në të. Metodika e punës në realizimin e studimeve për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës.

4. Rëndësia e grumbullimit dhe trajtimit të informacionit për aplikimin gjeografik. Llojet i informacionit, mënyrat e grumbullimit, trajtimit dhe përdorimit të tyre për studime në fushën e gjeografisë.

5. Analiza e efekteve. Ndikimet, pasojat, efektet që sjell aplikimi gjeografik. Vlerësimi dhe kontrolli i suksesit. Analiza e efektivitetit të masave të marra. Vrojtimet hapësinore të vazhdueshme.

6. Shembuj konkretë të aplikimit gjeografik.

- Shembuj të aplikimit gjeografik në fushën e gjeografisë fizike dhe gjeomorfologjisë dhe mjedisit (Risnjët natyrore, degradimi i relievit, përmytjet e lumenjëve etj.).
- Shembuj të aplikimit gjeografik në fushën e studimit të popullsisë dhe ekonomisë (migrimet e popullsisë dhe efektet e tyre, transformimi ekonomik dhe e ardhmja e zhvillimit ekonomik të vendeve dhe zonave të ndryshme).
- Shembuj të aplikimit gjeografik në studimet rajonale dhe lokale (pabarazitë në zhvillimet rajonale dhe lokale midis rajoneve të ndryshme, rajonet që braktisen dhe ato që mbipopullohen, rajonet e bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të eurorajoneve).

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Projekt-studim	50% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

1. H. Götz, G. von Rohr: Gjeografi e zbatuar. (Përkthyer nga gjermanishtja Ethem Lika). Shtëpia Botuese Dituria. Tiranë 2002.
2. G. Saupe: Cikël leksionesh në Gjeografinë e Zbatuar. Rregullim dhe Planifikim Territori. Universiteti i Potsdamit, Instituti i Gjeografisë. Potsdam – Gjermani 2005.
3. Dh. Doka: Tipare gjeografike të zhvillimit socio-ekonomik dhe rajonal në Shqipëri pas vitit 1990. Potsdam – Gjermani 2005.
4. Dh. Doka: Studimi i aftësive të mjedisit për projektet turistike. Artikull në revistën: “Gjeografia dhe Ekonomia”. Konferenca e II-te e Gjeografisë. Shkoder, 1995.

MIRATOI

**Përgjegjësi i Departamentit
Prof. dr. Romeo HANXHARI**

Tiranë, 2016